

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE

"Interlane Albania" SHPK

Ne baze te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar si dhe te Ligjit 9723, date 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar, Ligjit nr 131/2015 "Për Qëndrën Kombëtare të Biznesit", unë :

- **Rei Dakli** , i biri i Hysen dhe Denada , lindur me 07/10/1998 ne Elbasan, Shqipëri , banues ne Canada , identifikuar nga Passaporta e tij canadeze me numer GK497240 dhe Nr. Personal CAN9810075M2411037, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar ;

shpall si më poshtë vijon:

Neni 1

Sot më 07/10/2021, Themelohet shoqeria e quajtur "Interlane Albania" SHPK me ortakë :

- **Rei Dakli** , i biri i Hysen dhe Denada, lindur me 07/10/1998 ne Elbasan, Shqipëri , banues ne Canada , identifikuar nga Passaporta e tij canadeze me numer GK497240 dhe Nr. Personal CAN9810075M2411037, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar ;

Neni 2

Selia e shoqerise do të jetë në adresën: Rr. Frederik Shiroka, Zona kadastrale 8210, vol 41, fq 101,Nr i Pasurisë 5/385/ND2-N10, Tiranë , Shqipëri.

Shoqëria mund të themelojë degë dhe filiale në të gjithë territorin e vendit si dhe jashtë tij me miratimin e organeve kompetente dhe në perputhje me legjislacionin e vendit ku do të hapen keto degë.

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte si me poshte:

- Të zhvilloj aktivitet në fushën e **Telemarketingut** , në fushën e ofrimit të shërbimeve të ndryshme online me mundësi telefonimi për prezantim mallrash e shërbimesh dhe oferta të ndryshme. Aktivitet në fushën e marketingut ne Web. Aktivitet në fushën e tregtisë elektronike edhe për llogari të palëve të treta. Aktivitet në fushën e ndërmjetsimit dhe përfaqësimit të të tretëve.



- Të zhvillojnë aktivitetet në fushën e import, eksport, prodhim e tregtim me shumice dhe me pakice të artikujve industrial, kryesisht të materialeve të mobilerisë dhe të tjera të ngjashme dhe të lidhura me to.
- Çdo lloj operacioni dhe transaksioni me lidhje me importin, eksportin, prodhimin, shperndarje dhe tregtim te mallrave ushqimor, industrial, konfeksione, paisje mobilerie,druri dhe shtepiake ne pergjithesi, elektro-shtepiake, kancelarike dhe te zyrave si me shumice dhe pakice, ne natyren e lendes se pare, produkteve gjysem te gateshme apo te gateshme, makinerive, paisjeve, pjeseve te ndertimit, teknologjive, perpunim dhe tregtim.
- Blerje, shitje, dhenie me qira te pasurive te paluajtshme.
- Shitblerje automjetesh dhe dhënia me qera e tyre.
- Dhenie konsulence teknike ne fusha te ndryshme qe kane lidhje me objektin e veprimtarise.
- Peshkim dhe turizem detar.
- Riparim dhe mirëmbajtje te artikujve shtëpiak elektrik ose jo.
- Ndertim dhe projektim objektesh te permasave te ndryshme, shtepi, vila, ndertesa shumekateshe dhe komplekse pallatesh.
- Ndertim ambiente dhe sistemim gjelberimi, parqe e lulishte, ndertime betoni dhe prodhime inertesh, ndertime rruge, ndertim hidrocentralesh dhe punime te sistemit elektrik.
- Shtypshkronje, shtypshkrime te karakterit sekret me elemente sigurie. Botimi i veprave te ndryshme dhe ne vecanti botimin e librave dhe materialeve shkollore dhe universitare, veprave letrare, veprave te ndryshme artistike, shtypje letrash me vlere, gazetave, veprimtari tregtare te artikujve te konsumit te gjere industrial e ushqimore, me shumice e pakice.
- Aktivitetet në fushën e turizmit, hapje hotelesh, bar-kafe, restorante etj.
- Shërbime të ndryshme komunale, publike, riparim objektesh dhe shërbime menaxhimi në fushën e shërbimeve publike.
- Tregtim të paisjeve dhe materialeve të ndryshme të sigurisë personale dhe kolektive.

Neni 5

Kapitali i shoqërisë ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri. Bashkëzotëruesit e një kuote, sipas nenit 72, të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", gëzojnë cilësinë si një ortak i vetëm."

Kapitali i regjistruar i shoqërisë përbëhet nga **një kuotë prej 400.000 lekë (Katërqindmijë), dhe është kontribut i Ortakut të vetëm :**

1. Rei Dakli, një kuotë në masën 100 % ose 400 000 lekë.

Ortakët e shoqërisë mund të vendosin për rritjen apo zvogëlimin e kapitalit në perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe sipas vendimit te Asamblese se Ortakëve.

Detyrimet e çdo ortaku kundrejt shoqërisë përballohen vetëm për pjesën e kapitalit të derdhur nga ai. Për detyrimet e tjera të shoqërisë ortaku nuk mban përgjegjesi.

Neni 6

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga organet e saj të cilat janë:

1. Asambleja e Pergjithshme.

2. Administratorët

Shoqëria ka si ortak të vetëm:

- **Rei Dakli**

dhe administrator me afat emërimi 5 vjeçar :

- **Rei Dakli** , i biri i Hysen dhe Denada, lindur me 07/10/1998 ne Elbasan, Shqipëri , banues ne Canada , identifikuar nga Passaporta e tij canadeze me numer GK497240 dhe Nr. Personal CAN9810075M2411037, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Mënyra dhe drejtimi i shoqërisë janë të përcaktuara në Statutin e shoqërisë.

Neni 7

Ortakët e shoqërisë janë të detyruar që të ruajnë sekretin e dokumentacionit dhe të informacionit si dhe eksperiencën e realizuar brenda kontekstit të shoqërisë dhe të evitojnë përhapjen e tyre goftë dhe pjesërisht.

Neni 8

Në se shoqëria do të likujdohet atëhere do të caktohet një komision likuidimi që do të parashtojë një bilanc likuidimi për miratim.

Neni 9

Çdo mosmarrëveshje që do të lindi në lidhje me këtë marrëveshje apo Shoqërinë (përveç atyre personale apo që nuk kanë të bëjnë me Shoqërinë), do të zgjidhet me mirëkuptim dhe do të diskutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje me mirëkuptim të mosmarrëveshjes, çështja do t'i kalojë për gjykim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË "Interlane Albania" SHPK

Rei Dakli

Rei Dakli
